



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MEKATRONIKË”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

E8-IV-21

Tiranë 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimit

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

| | | | | |
|---|--|--------|--|--------------------------------|
| Emërtimi i kualifikimit | “Mekatronikë” | | | Kodi E8-IV-21 |
| Kohëzgjatja | 1900-2100 orë | Niveli | IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK | |
| Qëllimi: | Qëllimi i kualifikimit profesional profili “Mekatronikë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë teknikë të mesëm për Mekatronikën, të jenë të aftë të punojë në linjat e automatizuara, sistemet e automatizuara të prodhimit dhe pajisjet e automatizuar të punimit, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që e rrethon | | | |
| Kriteret e përgjithshme të pranimit: | <p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Mekatronikë” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në “Elektroteknikë”, nivelit II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. | | | |
| Mundësitë e kualifikimit të mëtjshëm dhe të punësimit: | <p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në <i>profilin</i> “Mekatronikë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të teknikut të mesëm në këtë fushë. Ky kualifikim i jep mundësinë individit t'i drejtohet tregut të punës në instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve apo pajisjeve të automatizuara etj. të industrisë së rëndë dhe të lehtë, si instalator i sistemeve inteligjente, ashensorëve, pajisjeve të kontrollit dhe supervizimit etj. në fushën e ndërtimit, për mirëmbajtjen dhe diagnostikimin e defekteve në sistemet automatike të automobilitave, në sistemet e menaxhimit të trafikut urban dhe infrastrukturës si: në mirëmbajtjen e semaforëve, pajisjeve të ndriçimit, kontrollit të tuneleve etj., në fushat e tregtimit dhe garancisë së pajisjeve industriale të automatizuara, si dhe mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e Mekatronikës.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Mekatronikë” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> | | | |
| Data e validimit | (kur të miratohet) | | | |
| Data e miratimit | | | | |
| Variantet e mëparshme | | | | |

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Menaxhimi dhe organizimi

- Të përshkruajë fushën e Mekatronikës, strukturën tekniko-ekonomike dhe tendencat e zhvillimit të këtij sektori;
- Të përshkruajë kuadri ligjor rregullator në sektorin e mekatronikës;
- Të shpjegojë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të përshkruajë hapat e përshkallëzimit të proceseve të punës për realizimin e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në punën e vet;
- Të dallojë materialet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të përshkruajë mjetet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të shpjegojë praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Të përshkruajë teknikat e vlerësimit të mjedisit të punës sipas projektit teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të tërësisë së materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë përgatitjen e një preventivi sipas projektit teknik;
- Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të identifikojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit në kohë dhe për ruajtjen e cilësisë;
- Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimin e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut;

Instalime të sistemeve dhe makinerive të automatizuara/ mekatronike

- Të përshkruajë elementët e projektit, mënyrën e zberthimit të tij si dhe skemat dhe simbolet;
- Të listojë pajisjet mekatronike duke përshkruar përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë pajisjet elektrike, informatike, mekanike, hidraulike/pneumatike dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë rrjetet (elektrik, rrjetin informatik, mekanik, hidraulik/pneumatik);
- Të përshkruajë sistemet e operimit mekatronik;
- Të përshkruajë llojet e elementëve elektronikë, funksioni dhe përdorimet e tyre;

- Të përshkruajë llojet e instrumenteve matës, funksioni dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë teknikat e montimit sipas llojit të sistemit dhe projektit;
- Të shpjegojë mënyrat e kabllimit sipas projektit dhe tipologjisë së pajisjes
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të instalimit dhe përdorimit të pajisjeve;
- Të shpjegojë llojet e testeve, mënyrat e testimit dhe instrumentet përkatës;
- Të përshkruajë mënyrat e instalimit të sistemeve të operimit në varësi të tipologjisë së pajisjes;
- Të përshkruajë llojet e elementeve mekanik, funksioni dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit fizik të sistemit apo makinerive e automatizuara;

Komisionimi i pajisjeve apo sistemeve të automatizuara/ mekatronike

- Të përshkruajë standardet shqiptare të instalimeve elektrike civile dhe industriale;
- Të përshkruajë standardet e instalimeve mekanike;
- Të interpretojë skemat elektrike, pneumatike, hidraulike;
- Të shpjegojë pajisjet dhe teknikat e matjeve elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të shpjegojë pajisjet HMI (Human Machine Interface) funksionin dhe përdorimin e tyre
- Të përshkruajë llojet e sinjaleve elektrike sipas manualit të instalimit dhe përdorimit;
- Të shpjegojë sistemet bazë me PLC dhe programimet bazë të tyre;
- Të listojë sensorët, ekzekutuesit e ndryshëm dhe parimin e punës së tyre;
- Të shpjegojë protokollat bazë të komunikimeve kompjuterike/industriale;
- Të përshkruajë pajisjet elektrike dhe elektronike të mbrojtjes dhe komandimit;
- Të shpjegojë teknikat e përshtatjeve të nevojshme në sistemet mekatronike

Përdorimi i sistemeve mekatronike

- Të shpjegojë rëndësinë e manualeve të përdorimit sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë llojet e lëndëve të para dhe karakteristikat e përpunimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit fizik të lëndëve të para dhe të produktit final;
- Të listojë llojet e defekteve kryesore në sistem gjatë operimit dhe mënyra e përcaktimit;
- Të shpjegojë teknikat e përshtatjes së parametrave të pajisjeve gjatë punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të kushteve teknike të mjedisit në funksionimin e sistemit dhe pajisjeve mekatronike;
- Të përshkruajë sistemet e komandimit dhe monitorimit të pajisjeve mekatronike;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit mekatronik për garantimin e procesit të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit në mënyrë eficiente të sistemit të automatizuar/mekatronike

Mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve mekatronike

- Të shpjegojë llojet e mirëmbajtjeve në sistemet dhe pajisjet mekatronike;
- Të listojë elementët e grafikut të mirëmbajtës dhe rëndësia e zbatimit të tij;
- Të përshkruajë teknikat e pastrimit të sistemeve mekatronike;
- Të shpjegojë teknikat e inspektimit të elementeve dhe sistemeve;
- Të listojë llojet e materialeve, mjeteve për lubrifikim dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë mënyrën lubrifikimet të pajisjeve ose komponentëve të sistemit
- Të listojë llojet e materialeve, etaloneve, mjeteve për kalibrim dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e kalibrimit të pajisjeve ose komponentëve të sistemit
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit dhe zëvendësimit të elementëve në fund të ciklit të jetës për sigurimin e vazhdimësisë së punës;
- Të përshkruajë llojet e programeve, teknikat e instalimit dhe rëndësinë e përditësimit të tyre;

Diagnostikimi i problemeve në sisteme mekatronike

- Të shpjegojë rëndësinë e matjeve elektro-mekanike në pajisje dhe krahasimit të parametrave me vlerat referuese në manualet përkatëse;
- Të interpretojë llojet e alarmeve të përgjithshme sipas manualeve të prodhuesit;
- Të përshkruajë llojet e sinjalistikës sipas problemeve përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të informacionit paraprak marrë nga përdoruesi;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit paraprak të historikut të defekteve në sistem;
- Të listojë llojet e defekteve kryesore në sistemet mekatronikë dhe rëndësinë e konsultimit me specialistë të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të problemeve dhe zgjidhjen e tyre;

Riparime të sistemeve të automatizuara

- Të përshkruajë teknikat e çmontimit dhe montimit të nyjeve, mekanizmave dhe agregateve të thjeshta;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të nyjeve mekanike, valvolat, ekzekutuesit (aktuatorët) etj.;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit dhe vendosjes e komponentëve elektrik dhe elektronik;
- Të shpjegojë rëndësinë e konfigurimeve të elementet elektronike të zëvendësuar;
- Të përshkruajë llojet e riparimeve elektrike dhe elektronike, si dhe teknikat e kryerjes së tyre;
- Të përshkruajë llojet e riparimeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike, si dhe teknikat e kryerjes së tyre;
- Të përshkruajë llojet e riparimeve të thjeshta në rrjetin e komunikimeve industriale;

Dokumentimi i punës së kryer

- Të listojë llojet e dokumentacionit teknik dhe përdorimet;
- Të përshkruajë dokumentacionin ligjor dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së dokumentacionit teknik apo ligjor sipas formateve të kërkuara;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të urdhrat të punës dhe mbyllja e tij;
- Të shpjegojë përdorimet e listës së kontrollit;
- Të shpjegojë rëndësinë e raportimit sistematik sipas hierarkisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të riparimeve apo modifikimeve të kryera;

Sipërmarrja dhe edukim për karriere

- Të përshkruajë konceptet bazë të sipërmarrjes;
- Të dallojë llojet e sipërmarrjeve;
- Të përshkruajë strukturat, organizimin dhe funksionimin e një sipërmarrje të vogël;
- Të argumentojë detyrimet dhe të drejtat ndaj institucioneve ligjore (QKB- Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Bashki etj.);
- Të përshkruajë shërbimet elektronike e-albania, e-tax etj.;
- Të dallojë konceptet financiare si: kosto, TVSH(tatim i vlerës së shtuar), takse doganore, fitim bruto, fitim neto, tatim fitimi, dividend, kontributet shëndetësore dhe sociale, kredi, financim, konkurrencë, shpenzim, bilanc, etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive teknike përmes edukimit të vazhdueshëm;
- Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me kolegë dhe e prorw me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësorë klientit;
- Të argumentojë rëndësinë e aftësisë për marrjen e iniciativave;
- Të shpjegojë aftësinë për zgjidhjen e problemeve teknike në mënyrë të pavarur ose si pjesë e një grupi kur kjo kërkohet;
- Të argumentojë aftësinë për të realizuar disa detyra në të njëjtën kohë;
- Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në kryerjen e punëve në rastin e detyrave të shumëfishta;
- Të argumentojë rëndësinë e zhvillimit të njohurive dhe aftësive për t'u përshtatur me kultura dhe mjedise të ndryshme shoqërore;

Komunikimi në mënyrë etike

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të Kodit të etikës;
- Të përshkruajë teknikat e punës në grup;
- Të listojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;

- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimi i TIK në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit profesional në gjuhë të huajë;

Rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë Standardet Shqiptare për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe shëndetit në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së rregullores së brendshme të organizatës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe shëndetit në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë teknikat e analizimit dhe menaxhimit të rreziqeve në mjedisin e punës;
- Të përshkruajë praktikat e përgjithshme të sigurisë në vendin e punës, përfshirë sjelljen e punonjësit, praktikat e mira të mirëmbajtjes së ambientit të punës, praktikat e sigurisë në lidhje me punën në lartësi, pajisjet e mbrojtjes personale etj.;
- Të përshkruajë rreziqe nga zjarri duke përfshirë efektet e tyre të dëmshme, dukuritë tipike dhe përbërësit e nevojshëm;
- Të vlerësojë menaxhimin e sigurisë ndaj rreziqeve të burimeve të rrymës elektrike, përfshirë parimet e vlerësimit të rrezikut, procedurat e raportimit, masat e kontrollit për të eliminuar ose minimizuar rreziqet "NEAR MISS";
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe mjetet që përdoren;
- Të listojë rreziqet nga zhurmat në mjedisin e punës;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të analizojë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit nga ndikimi i fushave magnetike dhe elektrostatische dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të listojë rreziqet kryesore nga lëndët toksike, radioaktive dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Menaxhim dhe organizim

- Të kryejë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të zbatojë hapat e përshkallëzimit të proceseve të punës për realizimin e detyrave dhe

- zgjdhjen e problemeve;
- Të vendosë prioritete në punën e vet;
- Të zbatojë teknikat e negocimit, menaxhimit e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të përzgjedhë materialet e nevojshme për zbatimin e një projekti teknik;
- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për zbatimin e një projekti teknik;
- Të zbatojë praktikatat e menaxhimit burimeve njerëzore;
- Të zbatojë teknikat e vlerësimit të mjedisit të punës sipas projektit teknik;
- Të llogarisë tërësinë e materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përgatisë një preventiv sipas projektit teknik;
- Të zbatojë hapat për mbikëqyrjen e ecurisë së një projekti sipas afatit në kohë dhe për ruajtjen e cilësisë;
- Të llogarisë koston dhe çmimin e një shërbimi;
- Të përdorë teknikat e marketingut;
- Të zbatojë kërkesat rregullatore për lejet, licencat, standardet apo kodet e praktikave që aplikohen për instalime, mirëmbajtje dhe riparime në rrjete mekatronikë;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit;

Instalime të sistemeve dhe makinerive të automatizuara/ mekatronike.

- Të zbërthejë elementët e projektit, skemat dhe simbolet;
- Të përdorë pajisjet mekatronike sipas funksioneve të tyre dhe proceseve të punës;
- Të instalojë pajisjet elektrike, informatike, mekanike, hidraulike/pneumatike;
- Të instalojë rrjetet elektrik dhe informatik;
- Të instalojë impiantet mekanike, hidraulike/pneumatike;
- Të përzgjedhë elementët elektronikë, sipas funksionit dhe përdorimeve të tyre
- Të kryejë programimin bazë të PLC;
- Të përdorë llojet e instrumenteve matës, sipas funksionit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e kabllave, sipas karakteristikave, funksionit dhe përdorimeve të tyre
- Të zbatojë teknikat e montimit sipas llojit të sistemit dhe projektit;
- Të kryejë kabllimin sipas projektit dhe tipologjisë së pajisjes;
- Të zbatojë manualët e instalimit të pajisjeve;
- Të realizojë testimet me instrumentet përkatës;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të sistemeve të operimit në varësi të tipologjisë së pajisjes;
- Të përzgjedhë elementet mekanik, sipas funksionit dhe përdorimeve të tyre;
- Të realizojë montimin fizik të sistemit apo makinerive të automatizuara;

Komisionimi i pajisjeve apo sistemeve të automatizuara mekatronike

- Të zbatojë Standardet Shqiptare të instalimeve elektrike civile dhe industriale;
- Të zbatojë standardet e instalimeve mekanike;
- Të zbërthejë skemat elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të përdorë pajisjet dhe teknikat e matjeve (elektrike, elektronike, mekanike);
- Të parametrizojë pajisjet elektrike dhe HMI (Human Machine Interface) kur është e kërkuar;
- Të identifikojë parametrat e funksionimit sipas manualit të instalimit dhe përdorimit;
- Të identifikojë sensorët, ekzekutuesit e ndryshëm;
- Të respektojë protokollet bazë të komunikimeve kompjuterike/industriale;
- Të dallojë pajisjet elektrike dhe elektronike të mbrojtjes dhe komandimit;
- Të përdorë teknikat e përshtatjeve të nevojshme në sistemet mekatronike;

Përdorimi i sistemeve mekatronike

- Të respektojë manualët e përdorimit sipas proceseve të punës;
- Të furnizojë me lëndë të para sipas kërkesave;
- Të realizojë kontrollin fizik të produktit apo shërbimit përfundimtar;
- Të identifikojë defekte kryesore në sistem gjatë operimit dhe mënyrën e përcaktimit të tyre;
- Të kryejë përshtatje të parametrave të pajisjeve gjatë punës;
- Të respektojë kushtet teknike të mjedisit gjatë funksionimit të sistemit dhe pajisjeve mekatronike;
- Të monitorojë sistemet e komandimit të pajisjeve mekatronike;
- Të zbatojë teknika të pastrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit mekatronik gjatë procesit të punës;
- Të përdorë në mënyrë eficiente sistemet e automatizuar/mekatronike;

Mirëmbajtja e sistemeve dhe pajisjeve mekatronike

- Të zbatojë grafikun e mirëmbajtës në sistemet dhe pajisjet mekatronike;
- Të zbatojë teknikat e pastrimit të sistemeve mekatronike;
- Të zbatojë teknikat e inspektimit të elementeve dhe sistemeve;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve, mjeteve për lubrifikim sipas përdorimit të tyre;
- Të kryejë lubrifikime të pajisjeve ose komponentëve të sistemit;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve, etaloneve, mjeteve për kalibrim sipas përdorimit të tyre;
- Të kryejë kalibrime të pajisjeve ose komponentëve të sistemit;
- Të zëvendësojë elementët në fund të ciklit të jetës për sigurimin e vazhdimësisë së punës;
- Të përditësojë programet e sistemeve dhe elementëve mekatronikë;

Diagnostikon problematikat e sistemeve mekatronike

- Të kryejë matje elektro-mekanike në pajisje dhe t'i krahasojë parametrat me vlerat referuese në manualët përkatëse;
- Të identifikojë llojet e alarmeve të përgjithshme sipas manualeve të prodhuesit;
- Të dallojë llojet e sinjalistikës sipas problemeve përkatëse;
- Të vlerësojë informacionin paraprak të marrë nga përdoruesi;
- Të konsultohet paraprakisht me historikun e defekteve në sistem;
- Të konsultohet me specialistë të tjerë për defektet kryesore në sistemet mekatronikë
- Të identifikojë defektet kryesore të sistemeve mekatronikë
- Të dokumentojë problemet dhe zgjidhjet e tyre;

Riparime të sistemeve të automatizuara

- Të zbatojë teknikat e çmontimit dhe montimit të nyjeve, mekanizmave dhe agregateve të thjeshta;
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit të nyjeve mekanike, valvolat, ekzekutues (aktuatorët) etj.
- Të zbatojë procedurat e zëvendësimit dhe vendosjes e komponentëve elektrik dhe elektronik;
- Të konfigurojë elementët elektronike të zëvendësuar;
- Të zbatojë teknikat e kryerjes së riparimeve elektrike dhe elektronike;
- Të zbatojë teknikat e kryerjes së riparimeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike;
- Të zbatojë teknikat e kryerjes së riparimeve të thjeshta në rrjetin e komunikimeve industriale;

Dokumentimi i punës së kryer

- Të përdorë dokumentacionin teknik/standardet/manualët dhe anekset e tyre;
- Të përdorë dokumentacionin ligjor dhe anekset e tyre;
- Të ruajë dokumentacionin teknik apo ligjor sipas formateve të kërkuara;
- Të përdorë urdhrin e punës dhe administrojë proceset e tij;
- Të zbatojë listë- kontrollin gjatë proceseve të punës;
- Të respektojë rregullat e raportimit sistematik sipas hierarkisë;
- Të dokumentojë riparimet dhe modifikimet e kryera;

Sipërmarrje dhe edukim për karrierën

- Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në një sipërmarrje biznesi;
- Të shfrytëzojë format e sipërmarrjes për karrierë personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të hartojë një plan biznesi sipas profilit përkatës;
- Të përdorë dokumentet financiare në kompani për të bërë analiza pune;
- Të menaxhojë aktivitetin e kompanisë duke respektuar buxhetin e përcaktuar;

- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të përdorë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të analizojë të dhënat për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë probleme në mënyrë krijuese;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë aftësitë personale, sociale dhe aftësitë për biznes, njohuritë e mëparshme për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar të tjerët në arritjen e synimeve;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesur për to;
- Të menaxhojë stafin dhe mundësinë e zhvillimit të karrierës profesionale të tyre;

Komunikimi në mënyrë etike

- Të zbatojë rregullat e komunikimit etik dhe profesional duke përdorur teknikat përkatëse;
- Të zbatojë kodin e etikës në veprimtarinë e vet;
- Të punojë në grup duke zbatuar teknikat dhe parimet përkatëse;
- Të zbatojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të përdorë TIK në komunikim;
- Të përdorë terminologjisë profesionale gjatë komunikimit në veprimtarinë e vet;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit profesional në gjuhë të huajë;

Rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të zbatojë Standardet shqiptare për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe jetës.
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të organizatës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë instalimit të pajisjeve dhe sistemeve;
- Të zbatojë rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Të përdorë mjetet e duhura të mbrojtjes personale për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Të zbatojë praktikatat e mira për menaxhimin dhe eliminimin e rreziqeve në mjedisin e punës;
- Të përdorë masat e sigurisë ndaj rreziqeve të burimeve të rrymës elektrike;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtëse nga zjarri;

- Të zbatojë procedurat e kontrollit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit;
- Të zbatojë rregullat dhe përdorë mjetet e duhura për sigurinë nga punë në lartësi, rrugë, etj.;
- Të përdorë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të zbatojë rregullat mbrojtëse nga zhurmat në mjedisin e punës;
- Të zbatojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përdorë rregullat mbrojtëse nga fushat magnetike dhe elektrostатike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë nga lëndët toksike, radioaktive;
- Të zbatojë rregullat e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;
- Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe mjetet që përdoren.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
-